



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.04.2024 të parashtruar nga Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani, e datës 07.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 02.04.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 02.04.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**Arsyetim**

Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani, me datën 07.04.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:**

- Vërtetim te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike;
- Shkelje te dispozitave materiale te LPP – së dhe RRPP – së
- Dispozitat e shkelura të LPP-së: neni 7.1, neni 59.2, neni 64, 68 par.2, 3, 4, neni 69 dhe 72;
- Dispozitat e shkelura të RRUOPP-së: neni 38.1, neni 40.8 dhe neni 45.22;

### Pretendimet ankimore

AK me date 02.04.2024 ka derguar dokumentin B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku ka njoftuar se shtat (7) nga tete (8) oferutesit jane shpallur te papergjegjshem dhe ka njoftuar se me kontrate eshte shperblyer OE BM Group SHPK. Po ashtu me dt.02.04.2024 na ka derguar edhe dokumentin B42-Leter Standarde per tenderuesin e eliminuar.

AK me rastin e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit, ka dhënë tri arsye të cilat konsiderojmë se janë nxjerrë me konstatim te gabuar dhe jo te drejte te gjendjes faktike, konstatime te cilat do t'i kundërshtojmë ne tri pikat si vijon me poshtë:

**Arsye 1.** -“Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Garancioni i ofruar eshte me kushtezim nese e fiton projektin do te shqyrtohet perkrahja financiare deri ne 4 mil, jo siç është kerkuar i pakushtezuar”

Kriteri i përcaktuar ne FTD ka qenë: “Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit)“.

Konsiderojmë se kur AK ne vlerësimin e konstatuar se ne si OE nuk e kemi përmbushur kërkesën, kinse garancioni i ofruar është me kushtëzimin “nëse e fiton projektin”, këtë konstatim e ka bërë duke u bazuar në mënyrë selektive vetëm në një parafrazim të autoritetit bankar, i cili edhe po të shikohej ne tërsi nga ana e AK, i njëjti do duhej të kuptohej se Banka Garancionin e ofruar e ka lëshuar për një “ngjarje të ardhshme, e cila pritet të ndodhë”, dhe se edhe Kërkesa 2 e

AK ka qenë e tillë, ka qenë kerkesë me 3 alternativa, respektivisht, citoj: “Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se: 1. Ka kapital financiar për realizimin e kontratës, 2. Ka mjete të gatshme në bankë, dhe 3. ose mbështetje bankare- qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro”. Pra po të shihet Garancioni i ofruar sipas Leter References, shihet qartazi se i njëjti përmbush të gjitha kriteret e kërkuara dhe nuk është i kushtëzuar, për arsyet se Procredit Bank, njofton se: “*OE Ada Consulting Group SHPK është duke zhvillu biznes me bankën dhe përdor produkte te ndryshme si depozita ne para të gatshme, transfere e tërheqje kombetare e nderkombetare të parave, dhe produkte e shërbime tjera*”, fakte këto që dëshmojnë se OE është solvent dhe ka para të gatshme ne bankë. Për me tepër konsiderojmë se AK ka dështuar që të vlersojë drejtë gjendjen faktike, kur nuk ka marrë për bazë garancionin që Procredit Bank ka dhënë ne Leter Referencën me nr.prot. OT-02-2081, dt.06.02.2024, kur ka garantuar se, citoj: “..klienti nuk posedon limit kreditor, rrjedhismisht Procredit Bank do të konsideroj përkrahjen financiare deri ne 4,000,000.00 EURO, pas analizës të bërë nga analistët tanë të kredive”, pra narracioni i ndërtuar nga AK se garancioni i ofruar është i kushtëzuar, është i padrejtë, pasi që kur konstaton se kinse garancioni i ofruar nga banka është me kushtëzimin “nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja”, këtë konstatim e rrëzon ne tërsi pjesa e dytë e fjalisë ne pasuesin 2 të Leter Referencës, e cila tregon në mënyrë të qartë se Ada Consulting Group SHPK “..nuk ka limit kreditor..”, pra nga kjo rrjedhë se OE nuk ka fare kufizim vlere se deri në sa mund të realizoj kredi, e që do të thotë se përkrahja prej 4,000,000.00 euro është konsideruar si çështje e mbyllur dhe e pakontestuar për bankën. Andaj tentativa e AK që përmes fjalës “nëse”, konsiderojmë se është një veprim selektiv, arbitrar dhe se qëllimisht nuk ka marrë për bazë kontekstin e çështjes, si dhe rrethanat kohore për çfarë është kërkuar garancioni.

Poashtu konsiderojmë se AK ka përdorur standarde të dyfishta të vlerësimit, kur sa i përket Garancionit të OE të shpallur fitues “BM Group SHPK”, ka konstatuar se garancioni i ofruar nga ta i përmbush kushtin për të qenë i pakushtëzuar, edhe përkundër se gjuha e përdorur ne leter referencen e shkruar për operatorin e shpallur fitues, është ne kuptimin e njëjtë, respektivisht kur Banka ka theksuar se, citoj: “... bazuar ne politikat e matjes dhe menaxhimit të riskut lidhur me mbeshtjetjen financiare...”, konsiderojmë se kjo shprehje ka kiptimin e njëjtë sikurse edhe tek garancioni ynë bankar, kur thuhet se: “pas analizës të bërë nga analistët tanë të kredive”, pasi që të dyja bankat flasin për një procedurë e cila zhvillohet pas aplikimit për realizimin e një kredie, ndërsa kur Banka e operatorit të shpallur fitues ka theksuar se, citoj: “Deshirojmë t’ju informojmë se Banka merr ne konsideratë...”, konsiderojmë se kjo shprehje ka kiptimin e njëjtë sikurse edhe tek garancioni ynë bankar, kur thuhet se: “...rrjedhismisht Procredit Bank do të konsideroj”. Pra AK gjatë vlerësimit të çështjes së njëjtë, ka favorizuar OE BM Group SHPK”, ne raport me ne si OE, duke përdorur standarde të dyfishta ne trajtim, me çfarë ka bërë shkelje të rëndë të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili percakton se: “*I. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, si dhe shkelje të nenit 68 te LPP-se me rastin e vlerësimit jo të drejtë sa i perket kerkesave ekonomike financiare, sipas kerkesave te FTD neni 8.1 -8.2,

**Arsye 2. - “Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 mbi mundësinë teknike dhe/pse profesionale-Nuk ka dëshmuar punë te kryera për dyer X-ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinika e Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik” .**

Kriteri i përcaktuar ne FTD ka qenë: “Së paku njëri projekt te jetë spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin ne rast te grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj”.

Konsiderojmë se kur AK ne vlerësimin e konstatuar se ne si OE nuk e kemi përmbushur kërkesën lidhur me punët e kryera për dyer X-ray Autoamtike, ka konstatuar gabimisht dëshmitë tona të ofruara ne tenderin e dorëzuar, pasi që Ada Consulting Group SHPK, ka provuar me fakte të vërtetuara se per projektin që përfshin pune te realizuara per X-Ray, kemi bashkangjit Kontratën e lidhur mes OE ACG-së dhe AK QKUK, të dt.05.07.2019, Raportet e Pranimit per projektin e teresishem si dhe raportin e pranimit per punet specifike X-Ray, dt.05.02.2023, (te cilat po i bashkangjesim vetem faqet kryesore edhe kësaj kërkesë për rishqyrtim), ku ne mënyrë të qartë vëtetohet se objekti i kësaj kontrate ka qenë për “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë, e ku sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës-PMK të dt.25.08.2019, të pergatitur nga Menaxherja e Projektit QKUK, palët ishin pajtuar që, citoj: “1. Duke u bazuar ne kërkesën e AK (përfituesit-Klinika e Ortopedisë) punimet do të behen fillimisht ne Objektin e ri-Klinika e ortopedisë, i cili objekt do te perfundohet ne tersi do te behet pranimi teknik i objektit te ri-klinika e ortopedise, bartja e stafit nga objekti ekzistues i sallove te operacioneve si dhe funksionalizimi ne tersi. 2. Pas pranimit teknik te pjeseshem te objekti te ri-Klinika e ortopedisë, do te filloj rrenimi dhe punimi i objektit tjetër”. Pra kur AK ka konstatuar se, citoj: “,.. për këtë projekt mungon pranimi teknik”, ka dështuar që të vlerësoj se puna ne këtë projekt ka qenë e organizuar ne dy faza nga vetë AK, me qëllim të funksionimit të Objektit të Ri-Klinika e Ortopedisë, për qka ne si OE edhe e kemi bërë të mundshëm bazuar ne PMK e dt.25.08.2019, dhe pikërisht për këtë arsye është konsideruar edhe pranimi i pjesëshëm, ku ne punët e kryera dhe të pranuar hynë edhe pozicionet e kërkuara sipas FTD-së.

AK per te vertetuar kete reference thjesht ka mundur te parashtroj kërkesë për sqarim sipas nenit 72 te LPP-se, dhe do kishim mundur te ofrojme qasje te plote ne dokuementet e komplet projektit, por nje gje te tille mund ta kishin vërtetuar lehtë edhe vetë, meqe projekti është realizuar për nje Institucion (QKUK) qe eshte ne vartësi të Ministrise se Shendetesise.

Konsiderojmë se me këtë rast, Komisioni vlerësues nese ka pasur mëdyshje ne atë se cfarë është “pranimi i pjesëshëm”, atëherë është dashur dhe ka mundur fare lehte që te kërkojë sqarime shitese, ashtu siç e obligojnë dispozita e nenit 59 te LPP, ne mënyrë qe te beje vlerësim sa me profesional dhe ne mënyrë qe paqartësitë e mundshme te sqarohen, andaj konsiderojmë se ne këtë rast AK ka dështuar qe të zbatoj dispozitat ligjore qe i mundësojnë qe te kërkoje qartësime, repektivisht ka shkelur nenin 59 par.2 te LPP, si dhe nenin 38.1 dhe 40.8, 45.22 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik (RRPP).

**Arsyeja 3.** - “Nuk e keni plotësuar Kërkesën 4 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-Mungon Certifikata për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit ne punë, z. Ahmet Morina. E ka prezantuar një Vendim nga MFPT, por jo certifikatën siç është kërkuar”.

Kriter ne FDT ka qenë: “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” Certifikata liçenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Ada Consulting Group SHPK, me tenderin e tij ka dorezuar Vendimin me nr.ref”:43011 dt.08.06.2023, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve, me të cilin dëshmohe se z. Ahmet Morina është i çertifikuar: **Ekspert per Sigurinë dhe Shendetin ne Punë**, fakt qe nuk mohohet as nga vet autoriteti kontraktues. Konstatimi i AK i përdorur nga AK për të na eliminuar nga tenderi, se, citoj: “...por jo certifikatën siç është kërkuar”, është konstatim i pabazuar, pasi që kualifikimi i një eksperti bëhet pas përfundimit të trajnimeve specifike dhe ne momentin kur i aprovohet kërkesa për Çertifikim nga organi kompetent (Komisioni për Siguri dhe Shëndetin ne Punë).

Ne rastin konkret AK ka dështuar që të vlerësoj drejtë lidhur me atë se kualifikimi i z. Ahmet Morina, është bërë ne pajtim të plotë me nenin 4 paragrafi 5, si dhe nenin 12 par 1 të Rregullores Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin ne Punë,

Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, me të cilët përcaktohet se: " Neni 4 par 5: - Personi që posedon kualifikimin e ekspertit për sigurinë dhe shëndetin në punë, i lejohet: 5.1 Të punojë si i punësuar në çdo kompani" , "Neni 12 par.1: - Një kandidat që i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, certifikohet si ekspert për sigurinë dhe shëndetin në punë. Vendimi merret nga Komisioni për Siguri dhe Shëndetin në Punë", pra Komisioni vlerësues i tenderve kur ka konstatuar se z. Morina nuk e ka certifikatën siç është kërkuar, ka mohuar një vendim tërësisht ligjor, mbi bazën e të cilit i njëjti është certifikuar dhe ka marr kualifikimin Ekspert për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë,

Me këtë rast duke mos ftuar OE që të qartësoj dokumentin e paraqitur, me të cilin dëshmohet se z. Morina është i certifikuar, ka shkelur nenin 72 te LPP-se.

Gjithashtu konsiderojmë se arsyet kur AK ka bërë "eliminimin" mbi bazën e e mosplotësimit të kërkesave të lartcekura, ai këtë e ka bërë në kundërshtim të plotë me nenin 64 te LPP-se i cili përcakton se: " Një kandidat ose tenderues do të dëshmojë me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji."

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që këtë Kërkesë për rishqyrtim ta APROVOJ si të bazuar dhe aktivitet e prokurimit me nr. prokurimi: 206-23-14371-5-1-1, ta kthejë në rivlerësim, ku me rastin e rivlerësimit duhet të caktohet një komision i ri vlerësues, dhe pas rivlerësimit oferta jonë të shpallet e përgjegjshme dhe njëkohësisht të rekomandohemi për shpërbllim me kontrate.

-----  
-----  
**Shkeljet e AK me rastin e shpalljes fitues të OE "BM Group SHPK," i cili është OE i përgjegjshëm;**

Me date 03.04.2024 ne si OE, bazuar në dispozitat ligjore kemi paraqitur kerkese per qasje ne dokumentacionin e fituesit, me pas me date 04.04.2024 kemi pranuar e-mail nga zyrtari i prokurimit te Ministrise se Shendetesise ku jemi njoftuar qe mund te vini per qasjen e kerkuar sot brenda orarit te punes – deri ne ora 16:00, ku edhe kemi shkuar per marrjen e dokumentacionit te kerkuar.

Pas vlerësimit të dosjes kemi gjetur se OE "BM Group SHPK" i shpallur fitues, as për së afërmi nuk i plotëson kushtet për tu shpallur fitues në tenderin në fjalë, dhe i njëjti duhet të shpallet i papërgjegjshëm, dhe atë për arsye të vijimit:

**1.Arsyeja e parë:**

Sipas kushteve të përcaktuara në FDT Neni 9.1&9.2 Kërkesa 3. ku është kërkuar: a)- Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me Staf Teknik min. 50 punëtor, prej tyre se paku 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë.

**Dëshmia 3.**

- Lista e stafit min. 50 punëtor, me profilin teknik të punëtorit,
- Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.
- Certifikatat e trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, për min. 20 punëtorë.

OE që është shpërblyer me kontratë (BM Group) ka prezentuar një listë me gjithsej 59 punëtorë, prej të cilëve 12 nga ta, si: Bajram Kiqina, Tafil Kiqina, Sami Bilalli, Shenjestar Kastrati, Hasan

Gashi, Shemsi Gllareva, Albert Hoti, Shpend Shala, Asdren Kelmendi, Islam Shala, Bleron Neziri, Florim Berisha, nuk kane fare kontrate, pra BM nuk ka prezentuar kontrate te punese siç eshte kerkuar ne kerkese e larte cekur, ndërsa për punëtorin Ejub Bërbatovci, kontratën qe e kanë prezentuar, e njëjta nuk është e nënshkruar.  
Pra, konsiderojmë se në këtë pikë OE "BM Group SHPK", duhet te shpallet i papergjegjeshëm, pasi që nuk ka plotësuar Kërkesën e listuar ne FDT Neni 9.1&9.2-Kerkesa 3a.

## 2. Arsyetja e dytë:

Sipas kushteve të percaktuar ne FDT Neni 9.1&9.2 Kerkesa 3. b)- Ne kuadër të stafit teknik, duhet te jetë se paku nga një udhëheqës për pozicionet kryesore të punimeve, të cilët duhen të jenë teknik të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvojë së paku dy vite pas diplomimit

- 1 Ndërtimtar
- 1 Elektricitist
- 1 Hidroteknik
- 1 Suvatues-Fasader
- 1 Murator
- 1 Hidroizolues
- 1 Instalues i ngrohjes qëndrore
- 1 Instalues gazi
- 1 Saldues i metalit
- 1 Bojagji-Moler
- 1 Montator i deryve dhe dritareve
- 1 IT (teknologji informacioni)

- Për 12 udhëheqësit b) kërkohen te Noterizuara Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt dhe diplomat e shkollës se mesme teknike.

Ndërsa ne Sqarimet e dates 05.02.2024 te derguar nga AK per kete kerkese thuhet:

**Përgjigje:**

AK-MSh me këtë kërkesë nuk ka pasur për qëllim të kufizoj konkurrencën e as të diskriminoj apo favorizoj ndonjë OE, por kjo kërkesë është vendosur me qëllim të mbështetjes se stafit teknik të cilët janë të kualifikuar me shkollim të mesëm teknik (ku nuk kemi specifikuar profile të shkollimit teknik).

Zbutet kërkesa për 12 udhëheqësit, lejohet ofertimi ose me diploma të shkollës se mesme teknike ose me certifikata profesionale të dhënë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Po ashtu ne dokumentin B54 Njoftim per Informata shitesë ose përmiresim gabimit, i derguar nga AK me date 08.01.2024 thuhet:

b)- Ne kuadër të stafit teknik, duhet te jetë se paku nga një udhëheqës për pozicionet kryesore të punimeve, të cilët duhen të jenë teknik të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvojë së paku dy vite pas diplomimit • 1 Ndërtimtar •

1 Elektricitist • 1 Hidroteknik • 1 Suvatues-Fasader • 1 Murator • 1 Hidroizolues • 1 Instalues i ngrohjes qëndrore • 1 Instalues gazi • 1 Saldues i metalit • 1 Bojagji-Moler • 1 Montator i deryve dhe dritareve • 1 IT (teknologji informacioni), Dëshmia 3. -

Lista e stafit min. 50 punëtor, me profilin teknik të punëtorit, – Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt. - Certifikatat e trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, për min. 20 punëtorë.

- Për 12 udhëheqësit b) kërkohen te Noterizuara Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt dhe diplomat e shkollës se mesme teknike ose certifikata profesionale të dhënë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

OE "BM Group SHPK" nuk ka plotësuar as këtë kërkesë sepse:

1. **Avdyll Morina**, i prezentuar si elektrikist - nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomë bachelor në drejtimin Inxhinieri i Elektroteknikës, dhe anje certifikim siç është kërkuar në FDT.

2. **Egon Hoti**, i prezentuar si Instalues i gazit -nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomën bachelor në drejtimin Inxhinier i Mekanikës, dhe një certifikatë trajnimi e cila është lëshuar nga "Medic" dhe është vështirë e lexueshme, po ashtu edhe një certifikatë trajnimi të lëshuar nga "G-Samaras" S.A. për mbajtjen e një trajnimi me datat 20 dhe 21 Mars 2023, pra trajnim dy ditorë dhe jo siç është kërkuar në FDT, diplomë e shkollës së mesme teknike, ose certifikatë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

3. **Besart Gashi**, i prezentuar si Instalues i Ngrohjes Qendrore-nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomën bachelor në drejtimin Inxhinier i Mekanikës dhe asgjë tjetër, pra nuk ka asnjë certifikim sipas kërkesave të FDT.

4. **Isa Gashi**, i prezentuar si hidroizolues-nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar një certifikatë nga Sika Serbia, e lëshuar për kompaninë Izolimi N.P. me të cilën thuhet se punëtori Isa Gashi ka mbajtur trajnimin teorik dhe praktik një ditore pra më 4 Prill 2017 në Beograd për përdorim të sika sarnafil, dhe asgjë tjetër, asnjë certifikim, apo diplomë e shkollës së mesme sipas kërkesave të FDT.

5. **Fetah Meleqi**, prezentuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve, ndërsa në kontratë është me pozitë Teknik i Ndërtimit. Për këto punëtoreshë BM Group SHPK ka prezentuar diplomë të shkollës së mesme si Teknik i Ndërtimit, por i njëjti nuk posedon certifikim apo diplomë sipas kërkesave të FDT, për të angazhuar si montator i dyerve dhe dritareve.

6. **Sami Elezi**, i prezentuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve. Edhe për këto punëtoreshë OE BM Group SHPK, ka prezentuar certifikatë të lëshuar nga "Aluminium" për mbajtjen e trajnimit një ditore pra më 16.05.2023 për Instalim të dritareve, trajnim ky i cili nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e FDT.

Pra OE "BM Group SHPK", duhet të shpallet i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë, pasi që nuk ka plotësuar Kërkesën e listuar në FDT Neni 9.1&9.2 Kërkesa 3b.

### 3. Arsyja e tretë:

Sipas kushteve të përcaktuara në FDT Neni 9.1&9. Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa .4.5. - Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimit – Hidro, së paku 5 vite përvojë pune profesionale;

Dëshmitë 4.3 – 4.10:

- Diplomat e noterizuara (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),
- CV e nënshkruara nga vetë inxhinierët,
- Kontratat ose marrëveshje të punës për këtë projekt (të noterizuara),
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës,
- Licenca me afat për gjeodetin ose kompaninë.

Ne rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani te licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti.

- Certifikata liçenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

OE "BM Group SHPK, ne pozitën e Inxhinierit te Diplomuar te Ndertimtarise –Hidro ka porezuar z.Muhadin Morina, CV e te cilit nuk eshte nenshkruar nga vet inxhinieri konform kerkeses se lartecukur, por eshte nenshkrua ne nje formë elektronike (duke perdorur programe si PDF, power point, paint, apo te ngjashme). Sepse nuk perputhet me nenshkrimin qe eshte bere tek kontrata per angazhim te inxhinierit ne ljale.

Pra OE BM Group SHPK duhet te shpallet i papergjegjeshem sepse nuk ka plotesuar kerkesen e listuar ne FDT Neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: Kerkesa 4.5.

#### 4. Arsyja e katërt:

Sipas kushteve te percaktuar ne FDT Neni 9.1&9. Kapaciteti teknik dhe professional: Kerkesa 4.10. - Një ekspert i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë  
Dëshmitë 4.3 – 4.10:

- Diplomat e noterizuara (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),
- CV e nënshkruara nga vetë inxhinierët,
- Kontratat ose marrëveshje te punës për këtë projekt (te noterizuara),
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës,
- Licenca me afat për gjeodetin ose kompaninë.

Ne rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani te licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti.

- Certifikata liçenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

OE "BM Group" SHPK, ne pozitën e Ekspert i Sigurise, ka prezentuar z.Muhamet Hamiti, i cili posedon nje certifikatë te leshuar nga Ministria e Punes dhe Mireqenies Socuiale, e cila është lëshuar me date 17.05.2027, e duke pasur parasysh kornizën ligjore respektivisht nenin 12 par 3 të Rregullores Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin ne Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin ne Punë, i cili përcakton se: "3. Certifikata e Ekspertit vlen pesë (5) vjet nga data e lëshimit.", rezulton se e njëjta është e skaduar dhe jo valide.

Pra OE BM Group SHPK duhet te shpallet i papergjegjeshem sepse nuk ka plotesuar kerkesen e listuar ne FDT Neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kerkesa 4.10

#### 5. Arsyja e pestë:

Sipas kushteve te percaktuar ne FDT Neni 30.1 Kriteret e Dhënies

Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;  apo [Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6

Shënim: Kërkohe nga OE qe gjate përgatitje se Formularit te tenderit ne platformën elektronike, te plotësojnë te gjitha nen-kriteret e TEMF: Çmimin dhe periudhën me të gjatë të Garancionit te puneve (min 2 vite).

Mosplotësimi i Formularit te tenderit si duhet do te shpije ne eliminim te ofertes.



**Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS<sup>2</sup>**

Është dashur te plotësohet ne pajtushmeri me sqarimet e dhëna ne dokumentin e dorezuar nga AK me date 05.02.2024 nen emertimin Sqarim e per Operator Ekonomik tek pika 7 Shqarime shtes nga AK-MSH

Sqarime shtesë nga AK-MSH

ESHTE				DUHET TE JETE			
Aneksi 6				Aneksi 6			
Kategorië	Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit	Kategorië	Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
Çmimi	Piket <100x 90 % > për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht.	90 %	$P = \frac{P_2}{P_1} \times [100x\%]$	Çmimi	Piket <100x 90 % > për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht.	90 %	$P = \frac{P_2}{P_1} \times [100x\%]$
Garancioni i punimeve (min 2 vite)	Piket <100x 10% > për periudhën me të gjatë të Garancionit të punimeve. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht.	10%	$D = \frac{D_2}{D_1} \times [100x\%]$	Garancioni i punimeve (min. 2 vite dhe maksimum 10 vite)	Piket <100x 10% > për periudhën me të gjatë të Garancionit të punimeve. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht.	10%	$D = \frac{D_2}{D_1} \times [100x\%]$
		100%				100%	

ku P- Pikët për tenderin, P<sub>2</sub>- Çmimi më i ulët, P<sub>1</sub> = çmimi i tenderit në vlerësim  
 ku D - Pikët për tenderin, D<sub>2</sub>= pikët për periudhën me të gjatë të garancionit të ofruar, D<sub>1</sub> = pikët për periudhën e garancionit të ofertes në vlerësim

Ju lutemi ta plotësoni edhe ANEKSEN 6.1 sa i përket afatit të furnizimit, i cili aneksi është pjesë e kësaj dosje.

ESHTE	DUHET TE JETE
Aneksi 6.1	Aneksi 6.1
I. AFATI I GARANCIONIT të këtij projekti është: _____ vite, nga data e fillimit të punëve	I. AFATI I GARANCIONIT të këtij projekti është: _____ vite, nga data e pranimit Teknik, respektivisht nga data e lëshimit të Certifikatës së pranimit preliminar, neni 33 i Kushteve të Përgjithshme të kontratës

Është kërkuar që ofertuesit te japin Afatin e Garancionit te këtij projekti \_\_\_\_\_ vite nga data e pranimit teknik, respektivisht nga data e lëshimit të Certifikatës së pranimit preliminar, neni 33 I Kushteve të Përgjithshme të kontratës.  
 OE “BM Group SHPK”, ka ofruar dhe plotësuar deklaratën në mënyrë të gabuar, duke dhënë garancion 7 vite nga data e fillimit të punëve, e jo ashtu sië është kërkuar me FDT, siç mund te shihni me posht:

**Aneksi - 6.1**

**AFATI I GARANCIONIT TE PUNËVE**

Për: (në vazhdim: "MINISTRIA E SHËNDETËSISË")

Në emër të: (BM GROUP SH.P.K) (në vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit:

"Vazhdimi i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK"

Numri i Prokurimit: 206-23-14371-5-1-1

**Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e garancionit**


DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriteri i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për AFATIN E GARANCIONIT TE PUNEVE TE KRYERA SIPAS KONTRATËS, DEKLAROJMË se do të përmbushim kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I. AFATI I GARANCIONIT të këtij projekti është: 7 vite, nga data e fillimit të punëve.  
(shëno numrin e viteve)

Te përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.

BM GROUP SH.P.K

Emri i përfunduarit të OE



Prandaj OE BM Group SHPK duhet të shpallet i papergjegjshem sepse nuk ka plotësuar siç duhet Deklaratën Aneksi 6.1, ashtu siç është kërkuara nga AK.

**5. Arsyeja e gjashtë:**

Sipas kushteve të përcaktuara në FDT Neni 9.1&9.2 Neni 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2

Sipas Sqarimeve derguar nga AK të datës 05.02.2024 kërkesa zbutet:

**DUHET TË JETË**

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses kontratën të ngjashme - ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njofftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Te dëshmohej se së paku ne njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.

OE "BM Group SHPK", ne listën e projekteve ka prezentuar kontrata te cilat janë nënshkruar dhe kane filluar ekzekutimin para afatit te kërkuar ne FDT si ne vijim

- **Ndertimi i Stadionit te qytetit te Gjilanit**, data e nënshkrimit është 08.01.2018, ndërsa përfundimi 08.07.2022, nderkohë që në kontratën e nënshkruar mes palve OE BM Group SHPK dhe Al Trade, tek Neni 1 {**Qellimi i Marrveshjes**}, përcakohet se: "*Qellimi i kesaj marrveshje per furnizim eshte furnizimi me materialet e nevojshme sipas parameses (ANEKSI) e cila eshte pjese perberese e kesaj marreveshje, per qellime te ndertimit te projektit me titull: "Ndertimi I stadionit te qytetit te Gjilanit"...*"  
Ndersa ne referencen e leshuar me 08.07.2022 nga Bau Holding, theksohet se: "*OE BM Group SHPK, me sukses ka perfunduar pjeserisht ndertimin e stadionit te Gjilanit ..*", prandaj referenca nuk përputhet me kontratën, për arsye se kontrat e nënshkruar mes palëve është vetëm për furnizim me material, dhe jo për ndërtim, prandaj kjo reference apo kontratë bie ndesh me kërkesen e AK te cekur me lart.  
Poashtu kontrata është nënshkruar ne vitin 2018, ndërsa kërkesa decidive e AK ka qenë te përfshihen kontrata me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë (njoftimi per kontrate eshte bere 03.01.2024).  
Sipas informacioneve qe dihen nga te gjithë permes medajave per kete project eshte nderprer kontrate dhe projekti nuk ka perfunduar asnjehere madje as ne ditet e sotme.
- **Kontrata Faza e pare renovimi i stadiumit te qytetit te Gjakoves**, është nënshkruar me date 02.04.2020, ku është cekur se projekti do te përfundoje per 36 muaj apo 3 vite andaj nuk mund te merret kompet vlere e projektit pasi qe kërkesa ka qene te oferohen kontrata ne vlere prej 25mil ne tri vitet e fundit rjedhimisht per vitet 2021, 2022 dhe 2023.
- **Kontrata per Ndertimin e stadiumit te qytetit – Faza dyte Drenas (projekt tre vjeqar)**, OE BM Group SHPK, ka prezentuar një reference e cila ka daten 11.01.2024 por nuk ka informacione se kur kane filluar punimet dhe kur kane perfunduar. Po ashtu ne kontraten e nenshkuar me 20.11.2018 tek Neni 3 {**Çmimi**} përcaktohet se: "*Çmimi i pergjithshem i kontrates 1,750,491.64 € Projekt eshte tre vjeqar, faza e pare 2018, Faza e dyte 2019 & faza e tretë 2020.*" Prandaj kjo kontrate nuk mund te merret per bazi pasi qe nuk ploteson kushtin e kerkuar nga AK.
- Per kontraten numer 5 ne listen e prezentuar me titull: **Ekzekutimi i punëve dhe furnizimi ne parking ne Prishtine**, e nënshkruar me 09.09.2020 mes paleve OE BM Group SHPK, dhe Parking Center, tek neni 1 përcaktohet se: "*Objekt I kesaj kontrate eshte bashkepunimi afarist mes paleve perkatesisht kryerja e punimeve: ne Ekzekutimin e punimeve (furnizim dhe pune) ne Parking Prishtne*" ndersa referenca e prezentuar nuk permban madje as daten e leshimit te references, e lëre me te dhena se kur kane filluar punimet, apo kur kane perfudua. Po ashtu nuk eshte e qarte sa nga vlere e kontrates ne total eshte furnizim me material, e sa punime dhe se këto punime a përfshijne ndertimin e objekteve te larta.
- Kontrata e e listuar ne list numer 17 me titull **Ndertimi dhe furnizimi ne objektet ne lagjen Marigona Hill**, e nënshkruar me date 25.05.2020 nuk eshte specifikuar sasia e furnizimit apo ndertimit ndersa AK nuk ka kerkuar asnje sqartim per kete edhe perkunder

faktit se ne FDT eshte cekur se *“Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare)”*

- Kontrata e e listuar ne list numer 19 me titull: **Punimet ne parkun industrial Miradi**, e nenshkruar me date 01.10.2021, e që në referencem e datës 15.02.2024, theksohet se: *“...Natyra e puneve te kontraktuara eshte ndertim i larte dhe punet e infrastruktures dhe faze tjera percjellese”*, pra nuk eshte specifikuar vlera monetare e furnizimit siç ceket ne kontrate, poashtu nuk eshte percaktuar vlera monetare e puneve te infrastruktures dhe vlera monetare e punimeve ne ndertim te larte. AK nuk ka kerkuar asnje sqartim per kete edhe perkunder faktit sre ne FDT eshte cekur se *“Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare)”*
- Ka edhe shume kontrate te cilat permbajne furnizim, punime ne ndertim te ulet, jane nenshkruar para vitit 2021 dhe AK nuk ka kerkuar asnje sqarim sipas udhezimeve dhe kerkesave te vendosura ne FDT dhe te sqaruara permes dokumenteve qe ka derguar gjate procedures si sqarimet e dates 05.02.2024 dokumenti B54 I dates 08.01.2024.

Te gjitha keto qe u than me lartë, jane fakte të cilat OE “BM Group SHPK” e bëjnë të jetë i papërgjegjshem, dhe se i njëjti është shpallur fitues në kundërshtim me kërkesat e vendosura nga AK, andaj kur AK e ka shpallur të njëjtin të përgjegjshëm dhe njëkohësisht edhe fitues të këtij tenderi, ka bere shkelje te ligjit duke mos trajtuar barabartë të gjithë ofertuesit, respektivisht me rastin e shpalljes se këtij OE fitues, ka favorizuar të njëjtio ne dëm të neve si OE me i lirë dhe me të gjitha kushtet e plotësuara, siç edhe e kemi theksuar ne pretendimet tona në pjesën e kundërshtimeve të aryesve për eliminim.

Andaj bazuar edhe mbi këto të gjetura, pas analizimit të dosjes së OE “BM Group SHPK” të siguruar përmes kërkesës për qasje, kërkjmë që me rastin e rivlerësimit të Kërkesës për rishqyrtim, ta shpallë të papërgjegjshëm OE “BM Group SHPK”, ndërsa OE “Ada Consulting Group SHPK”, ta shpallë të përgjegjshëm, dhe të na rekomandojë për shpërbllim me kontratë.

#### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:**

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 1, per arsyen e eliminimit rreth Garancioni9t te ofruar bankar, nuk pajtohem me kete pretendim, meqense Leter referencia e ofruar nga ana juaj nga ProCredit Bank specifikon se *“...do te konsideroj perkrahjen financiare deri ne 4 milion euro, pas analizes financiare...”*:

Nëse klienti fiton projektin **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”**; Nr.Prokurimit: **206-23-14371-5-1-1**. Klienti aktualisht nuk posedon limit kreditor rrjedhimisht ProCredit Bank do të konsideroj perkrahjen financiare deri në 4,000,000.00 EURO, pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive.

Kjo nuk e plotëson kërkesën e NJK dhe DT ku është kërkuar **mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro**. Per kete çeshtje ekzistojne vendime te OSHP-se qe e sqarojne kur kerkohe qasje e pakushtezuar dhe kur jo.

Refero vendimit te OSHP-se nr. 396/23, 400/23 te dates 10.08.2023 ku nder te tjera potencohet se:

të gatshme bankare dhe nuk do të ketë qasje në kredi. Duke i analizuar nga ky aspekt shpjegimet nga raporti i ekspertit dhe duke i krahasuar sërish të gjitha këto me DT, konstatohet se Kërkesa e DT përmban formulimin si në vijim, cituar: "Operatori Ekonomik duhet të ketë mjete financiare te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme ne bankë në vlerë prej së paku 1,000,000.00 € ose dëshmi mbi akses ne kredi nga një Banke, për te njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit aktivitet të prokurimit". Kjo do të thotë (nga pikëpamja e Panelit) se sipas këtij kriteri dhe/ose kërkesë, nënkuptohet se OE i rekomanduar e ka plotësuar kërkesën e DT, përderisa për këtë aktivitet të prokurimit nuk është kërkuar që qasja në ndonjë kredi eventuale të jetë, cituar: "e pakushtezuar" dhe rrjedhimisht pohimi ankimor në këtë rast kualifikohet si i pabazuar<sup>1</sup>. PSH këtë e mbështet edhe në konsistencë të vendimeve tjera të PSH me nr. 494/22;495/22;497/22; 500/22;503/22;505/22; 510/22;547/22;548/22;600/22;810/22.

Refero vendimit te OSHP-se nr. 505, 494, 510, 503, 497, 495, 537, 540, 500, 547, 548/22 te dates 09.12.2022 ku nder te tjera potencohet se:

tenderit. Nga provat e ofruara nga OE ankues figuron se në të dyja rastet mbështetja/qasja në kredi është e kushtëzuar nga autoritetet bankare. Kështu, në letrën e ofruar nga RBKO thuhet se "nëse klienti i plotëson kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës për një kredi të tillë". Ndërsa në letrën e NLB Bankës mbështetja kushtëzohet pasi thuhet "Prandaj, me kusht nëse kompania B CORP SH.P.K i plotëson të gjitha konditat ndaj NLB Banka.." Në të dyja rastet mendimi i ekspertit është se mbështetja nga Banka është e kushtëzuar dhe se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se ankesa është vetëm pjesërisht e bazuar në kuptim nenit 108/A me qenë se AK nuk janë përgjigjur pretendimit ankimor. Megjithatë kjo sipas mendimit tonë nuk ndryshon rezultatin final për arsyet e cekura më lart.

Ndërsa sa i perket pretendimit se edhe OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar kërkesën për mbështetje të pakushtezuar bankare 4 milion euro, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka deshmuar mbështetje bankare te pa kushtezuar (limit te aprovuar 3.4 + 3 mil euro) ne total prej 6.4 milion euro, shih deshmitë:

Theksojme se kompania BM Group shpk, me nr. identifikues 810839251 është klient i bankës tonë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Kemi diskutuar qëllimin e kompanisë në fjalë për mbështetje financiare sipas referencës "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

BM Group shpk, aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit të aprovuar prej EUR3,400,000.00 dhe banka është e hapur të përkrahë çdo kërkesë të klientit bazuar në kriteret dhe procedurat e brendshme të bankës për kreditim për projektin: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Deshirojme t'ju informojme se banka merr në konsideratë me interes të veçantë çdo kërkesë financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë.

Theksojmë se Kompania "BM GROUP SHPK", me numër identifikues 810839251, me pronar **Bedri Gllareva**, është klient i bankës tonë. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanisë në fjalë për mbështetje financiare sipas Referencës: **"Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"**

" **BM GROUP SHPK** ", aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit të aprovuar prej **3,000,000 EUR** dhe banka është e hapur të përkrah çdo kërkesë të tij bazuar në politikat e matjes dhe menaxhimit të riskut lidhur me meshtetjen financiare bazuar Referencën **"Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente në QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"**

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 2, për arsyen e eliminimit në lidhje me punët e kryera për dyer X-ray automatike në Kl. e Ortopedise së mungon pranimit teknik, nuk pajtohemi pjesërisht me këtë pretendim, duke marrë parasysh se vlerësimi teknik i ofertave për këtë projekt është bërë nga dy inxhinierë të QKUK-se, që MSH i ka besuar mendimit të tyre profesional, e të cilët ishin në dijeni rreth punëve të kryera në këtë projekt.

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 3, për arsyen e eliminimit në lidhje me mungesën e Certifikatës për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë, z. Ahmet Morina, nuk pajtohemi me këtë pretendim, duke marrë parasysh se kriteret e specifikuar në NJK dhe në DT kanë qenë të qarta dhe si dëshmi për këtë kriter është kërkuar:

**Kërkesa: 4.10. - Një ekspert i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.**

**Dëshmia: - Certifikata licenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.**

Sa i përket pretendimit se pse nuk kemi kërkuar sqarime shtese conform nenit 72 të LPP-se, duke marrë parasysh se kjo nuk ka qenë magnesia e vetme në ofertën tuaj, AK nuk e ka parë të nevojshme një gjë të tillë.

Sa i përket pretendimit (arsya e parë) se OE i rekomanduar nuk i ka ofruar 12 kontrata të punetoreve prej 59 punëtorë të prezantuar në listën e punetoreve teknik, nuk pajtohemi me këtë pretendim, duke marrë parasysh se pikërisht për këta punëtorë që ju pretendoni, OE i rekomanduar ka prezantuar certifikatat për siguri dhe shëndet në punë në emër të punëtorit dhe të kompanisë së rekomanduar, kjo është dëshmi e mjaftueshme për AK se OE i rekomanduar posedon me staf të mjaftueshëm teknik.

Në i kemi kërkuar 20 punëtorë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, ndërsa OE i rekomanduar i ka prezantuar 51 sosh, të gjithë me certifikata edhe në emër të kompanisë.

Si shembull shih njerin prej tyre që ju e keni kontestuar:



Në bazë të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Neni 20, si dhe në përputhje Licencës Nr. 03/2018, për ushtrimin e punëve profesionale nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, kompania NMA SH.P.K., lëshon këtë:

# CERTIFIKATË

## Bajram Kiqina

Për pjesëmarrje në trajnimin nga Siguria dhe Shëndeti në Punë

Punëdhënësi: BM GROUP SH.P.K.

Pozita e punës: Mjeshtër

Nr. i certifikatës: 4102/2022



Data e trajnimit: 30.09.2022

Data e lëshimit: 04.10.2022

Data e skadimit: 03.10.2024

Kjo certifikatë lëshohet bazuar në trajnimin e realizuar dhe në përputhje me autorizimet e licencës nga MPMS, me Nr. 03/2018.

Adresa: NMA Sh.P.K., Rr. Ferid Curri, Arbëri – Prishtinë  
www.nma-ks.com; info@nma-ks.com; +383 (0) 44 11 90 09

Sa i perket pretendimit (arsya e dyte) se OE i rekomanduar nuk i ka ofruar 12 udheheqesit e puentoreve me kualifikimet e kerkuara me diploma te shkules se mesme teknike, ky pretendim eshte i pa bazuar, duke marre parasysh se udheheqesit ne fjale OE i rekomanduar i ka ofruar me klualifikimet Bachelor te drejtimeve inxhinierike, duke e tejkeluar kerkesen e AK.

Sa i perket pretendimit (arsya e trete) se OE i rekomanduar e ka ofruar Inxh. E ndertimtarise z. Muhadin Morina me CV te nenshkruar elektronike, ky pretendim eshte i pa bazuar, meqense ne dokumentacionin e ofertes ekziston CV me deshmi per experience shume te madhe te ketij inxh, me nenshkrim elektronik qe eshte i lejuar ne kete shekull te elektronikës, gjithashtu jane te gjitha dokumentet e kerkuara, kontrata e noterizuar, diploma e noterizuar, referencat e mjaftueshme, etj.

Sa i perket pretendimit (arsya e katert) se OE i rekomanduar e ka ofruar z. Muhamet Hamiti, me certificate te leshuar me date 17.05.2027 dhe e cila eshte e skaduar, ky pretendim eshte i pabazuar, duke marre parasysh se aktualisht ne jemi ne vitin 2024 dhe ende nuk eshte bere viti 2027, por certifikata ne fjale eshte e leshuar me 17.05.2017 nga Ministria e Punes dhe mlreqenies Sociale dhe nuk ka date skadimi, andaj per AK ka qene e pranueshme duke marre parasysh se eshte leshuar nga Institucioni Shtetedor i RK dhe eshte document i noterizuar.

Sa i perket pretendimit (arsya e peste) se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar si duhet Formularin e tenderit, konkretisht garancionin sipas Aneksit 6.1, kete pretendim e konsiderojme si pjeserisht te bazuar, port e shtate ofertat tjera ne kete aktivitet e kane plotesuar ne menyre te njejte Aneksin 6.1, sipas shabllonit te Dosjes se tenderit, duke mos e perfshire sqarimin e dhene te dates 05.02.2024.

Duke marre parasysh se ne si AK pervec sqarimit shtese ne fazen e tenderimit nuk e kemi ngarkuar te permiresuar Aneksin 6.1 atehere e konsiderojme si te pa drejte eliminimin e OE per kete pike, duke marre parasysh se OE e kane plotesuar nga DT kete aneks, ndersa eshte dasht qe ne ta ngarkojme si okument shtese te korrigjuar ne menyre qe kjo te jete e kjarte per te gjithë ofertuesit.

Kete gje e konsiderojme si devijim te vogel, konform nenit 59.4 te LPP-se, ndersa ne kontrate do te pershkruhet ne menyre te sakte si qeshte me sqarime shtese si:

**I. AFATI I GARANCIONIT** të këtij projekti është: 7 vite, nga data e pranimit Teknik, respektivisht nga data e lëshimit te Certifikatës se pranimit preliminar, neni 33 i Kushteve te Përgjithshme te kontratës.

Sa i perket pretendimit (arsya e gjashte) se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar kriterin rreth puneve te kryera ne projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar Listen e projekteve ne total 30,901,003.51 euro, ku vetem me UNOPS i ka mbi 4.7 milion euro, mbi 6.2 milion euro ne Punimet ne Parkun Industrial ne Miradi, mbi 4.3 milion ne lagjen Marigona Hill, mbi 3.3 milion ne qendren Park Plaza Podujeve, mbi 1.3 milion euro ne parkingun e Prishtines, mbi 1.7 milion ne stadiumin e qytetit te Drenasit, etj.

Ju rikujtojme se permes Sqarimeve shtese te publikuara me daten 05.02.2024 eshte lehtesuar ky kriter, ku eshte specifikuar se **"1. Pranohen edhe investimet private (si investime ne ndërtim te ndërtesave afaristo banesore). Pranohen objektet individuale, pranohen ambulatat."**

Gjate vleresimit te ketij aktiviteti AK ka pasur parasysh nenin 1 te LPP-se Qellimin e aktivitetit per realizimin e projektit, duke e rekomanduar per kontrate OE sipas Kriterit te dhenies se kontrates Oferta Ekonomikisht me e favorshme, ku nese perlogariten Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni i puneve te kryera 7 vite 10%, atehere oferta e rekomanduar eshte fituese edhe sikur te gjitha ofertat te ishin te pergjegjshme.

Mangësitë e vogla ne ofertën e OE te rekomanduar i konsiderojmë si devijime te vogla, konform nenit 59.4 te LPP-se.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**

**Vendimi i dorëzohet:**

1. Grup i OE ADA & SHM Arch & Vllezerit Asllani,
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**